

Termat e Referencës

*“Shërbim Projektimi të Rrjetit Elektrik Shpërndarës dhe
Sistemit të Ndriçimit në Parkun Kombëtar të Butrintit”*



1. Informacion i Përgjithshëm

Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit (Fondacioni/FMB) është themeluar nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë (MTKS) dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) si një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësim.

FMB vepron në fushën e trashëgimisë kulturore dhe në mënyrë specifike qëllimi i saj është administrimi indirekt i nënzoneve të trashëgimisë kulturore, të Parkut Kombëtar të Butrintit, një pronë me vlerë universale, në përputhje me Ligjin Nr. 50/22 *“Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”*.

1.1 Baza ligjore

Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me:

- Ligjin 27/ 2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”
- Vendim nr. 1125, datë 30.12.2020 për “Miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”.
- Vendim nr. 1099, datë 24.12.2020 për “Miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”.
- Vendimi i KKTKM, Nr. 527, Datë 13.12. 2024 për “Përbërjen e Manualit të Restaurimit, pikturën murale, drurin e dekoruar dhe mozaikun”.
- Konventat Ndërkombëtare të Restaurimit.
- VKM Nr.220, datë 7.4.2021, “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”.
- Vendimi i Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë për "Miratimin e Manualit të Çmimeve në fushën e Restaurimit".
- Ligji Nr. 8402, datë 10.9.1998, "Per kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", (Ndryshuar me ligjet: nr. 9200, datë 26.2.2004; nr. 9794, datë 23.7.2007; nr. 9826, datë 11.11.2007; nr. 10324, datë 23.9.2010; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 23, datë 8.6.2011; nr.11/2012, datë 9.2.2012; nr.20/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 3/2020, datë 30.1.2020, nr. 120/2020, datën 7.10.2020) .
- VKM nr. 425, datë 27.5.2020 "Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore".
- VKM Nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

- VKM Nr.391, datë 19.6.2004 “Për disa shtesa në vendimin nr.68, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve dhe kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”.
- VKM Nr. 68, datë 15.02.2001 “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”.
- VKM Nr. 4, datë 10.1.2003 “Për disa shtesa në vendimin nr.68, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”

1.2 Baza ligjore ndërkombëtare

Projekti do të hartohet dhe zbatohet në përputhje me standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë:

- Konventën e UNESCO-s për Trashëgiminë Botërore;
- Udhëzimet e Kartës së ICOMOS për ndërhyrjet në site arkeologjike;
- Udhëzimet e Kartës së ICOMOS për Interpretimin dhe Prezantimin e Vendeve të Trashëgimisë Kulturore
- Parimet e Dark Sky Lighting për reduktimin e ndotjes nga drita;
- Praktikrat e zbatuara në site të ngjashme.

Këto referenca përbëjnë bazën teknike dhe konceptuale për hartimin e projektit dhe garantojnë përputhshmërinë e tij me standardet më të larta ndërkombëtare.

2. Qëllimi dhe Objektivat e Shërbimit

Qëllimi i këtij shërbimi është hartimi i një projekti profesional, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm për instalimin e rrjetit elektrik dhe ndriçimin e jashtëm të Parkut Kombëtar të Butrintit. Projekti synon të trajtojë ndriçimin si mjet interpretimi, orientimi dhe sigurie, duke respektuar në mënyrë strikte vlerat arkeologjike, historike, natyrore dhe ekologjike të sitit.

Projekti do të përfshijë:

- Hartimin e projektit të shpërndarjes së rrjetit elektrik;
- Ndriçimin monumental të monumenteve dhe strukturave arkeologjike;
- Ndriçimin funksional dhe diskret të itinerareve të lëvizjes së vizitorëve ku gjykohet i nevojshëm.
- Hartimi i planit të mirëmbajtjes.

Objektivat kryesore të shërbimit janë:

- Përmirësimi i përvojës së vizitorëve përmes ndriçimit të kontrolluar, interpretues dhe të qëndrueshëm;
- Rritja e sigorisë dhe orientimit gjatë lëvizjes në park, veçanërisht në orët e mbrëmjes;
- Valorizimi arkitektonik, historik dhe peizazhor i monumenteve;
- Minimizimi i ndikimit mjedisor dhe reduktimi i ndotjes nga drita;
- Mbrojtja e biodiversitetit, faunës së natës dhe ekosistemeve të ndjeshme;

Butrint Management Foundation

info@bmf.al

Parku Kombëtar Butrint, SH81, Sarandë, Shqipëri

- Respektimi i plotë i legjislacionit kombëtar dhe standardeve ndërkombëtarë në fuqi;
- Shtimin e burimeve të energjisë dhe pikave të lidhjes për efekt të mirëmbajtjes së Parkut;
- Projekti, duhet të përfshijë Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe në Trashëgimi në përputhje me Udhëzimet e UNESCO-s.

3. Përshkrimi i Zonës

Zona kryesore arkeologjike e qytetit Antik të Butrintit ndodhet në brendësi të Parkut Kombëtar. Ajo shtrihet mbi një kodër në skajin Jugor të gadishullit të Ksamilit, e rrethuar nga liqeni i Butrintit, rreth 18 km në jug të qytetit të Sarandës.

Kjo zonë ka pesë pjesë kryesore, Akropolin, Citadelën veriore, pjesa që shtrihet kryesisht nga ana veriore e kodrës, me pamje nga liqeni, Agoranë në pjesën më të ulët në anën jugore të qytetit, një Lagje përtej kanalit të Vivarit si dhe Nekropolin ose varrezat në shpatin e kodrës përballë, në anën perëndimore.

Akropoli përbën pjesën më të lartë të qytetit, ku gjendet një fortifikim i mesit të shek VII p.e.s me sipërfaqe 0.7 ha. Mbi bazën e tij është formuar qyteti i mirëfilltë rreth fundit të shek.V p.e.s, i rrethuar me një mur prej blloqesh të mëdha poligonale e trapezoidale, me gjatësi 700m. Pothuajse gjithë linja e fortifikimeve të periudhave të ndryshme në Akropol janë ndërtuar me blloqe të mëdha gëlqerore të punuara trashë. Agoraja është zona shoqërore ku janë vendosur monumentet më të rëndësishme: Teatri, Tempulli i Asklepit, Prytaneioni, Stoa, etj., si dhe më vonë gjatë Periudhës Romake në këtë zonë përveç të tjerave u ndërtuan Termet, kompleksi i Forumit dhe Gjimnazi.

Më në jug të Forumit ndodhet qendra bizantine me monumentet si Pallati i Trikonkës, Pagëzimorja dhe Bazilika e Madhe. Përgjatë gjithë shtegut turistik kryesor dallohen edhe rrënoja arkeologjike të tjera që i përkasin periudhave të ndryshme të vendbanimit në këtë zonë.

5. Parimet e Përgjithshme të Ndërhyrjes dhe Kriteret e Ndriçimit

5.1 Qasja konceptuale

Ndriçimi në Parkun Kombëtar të Butrintit do të konceptohet si një ndërhyrje minimale, e kontrolluar dhe plotësisht e kthyeshme, e cila nuk ndryshon karakterin, leximin historik apo integritetin arkeologjik dhe natyror të sitit. Ndriçimi nuk do të ketë karakter dekorativ, por interpretues dhe funksional.

5.2 Parimi i ndërhyrjes minimale

Projektimi dhe zbatimi i ndriçimit do të shmangë çdo ndërhyrje të panevojshme në strukturat arkeologjike, monumentet dhe mjedisin përreth.

Ky parim synon:

- Minimizimin e ndikimit vizual dhe fizik të pajisjeve ndriçuese;
- Ruajtjen e autenticitetit dhe integritetit të monumenteve;
- Garantimin e kthyeshmërisë së çdo zgjidhjeje teknike;
- Mbrojtjen afatgjatë të vlerave kulturore dhe mjedisore të Parkut Kombëtar të Butrintit.

5.3 Parimi i ndriçimit selektiv

Ndriçimi do të aplikohet vetëm në monumente dhe segmente itinerari me rëndësi përfaqësuese, interpretative dhe funksionale.

Ndriçimi i përgjithshëm i gjithë parkut nuk konsiderohet praktikë e pranueshme, pasi:

- Rrit ndotjen nga drita;
- Cënon karakterin natyror të sitit;
- Bie ndesh me parimet e ruajtjes së trashëgimisë.

5.4 Parimi i ruajtjes së errësirës natyrore (Dark Sky)

Projekti i ndriçimit do të jetë në përputhje me parimet e **Dark Sky Lighting** dhe rekomandimet ndërkombëtare për menaxhimin e peizazheve kulturore, duke garantuar:

- Eliminimin e emetimit të dritës mbi horizont dhe drejt qiellit;
- Përdorimin e ndriçimit të drejtuar dhe të kontrolluar;
- Temperatura ngjyre 2700–3000K, të përshtatshme për zonat arkeologjike dhe natyrore;
- Shmangien e ndriçimit të panevojshëm të zonave natyrore;
- Kufizimin e intensitetit dhe kohëzgjatjes së ndriçimit përmes sistemeve të kontrollit.

Kjo qasje është në përputhje me rekomandimet e UNESCO-s për menaxhimin e peizazheve kulturore.

5.5 Parimi i mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit

Projekti do të marrë në konsideratë mbrojtjen e ekosistemeve të ndjeshme, në veçanti habitateve natyrore dhe ekosistemeve ujore dhe pyjore, duke shmangur çdo ndikim negativ nga ndriçimi artificial.

Intensiteti, drejtimi dhe kohëzgjatja e ndriçimit do të përshtaten me ciklet natyrore dhe ndjeshmërinë ekologjike të zonës.

5.6 Parimi i kthyeshmërisë

Çdo ndërhyrje ndriçuese duhet të jetë:

- E kthyeshme;
- Pa gërmime destruktive në shtresat arkeologjike dhe pa cënuar stabilitetin e terrenit;
- Pa dëmtim të strukturave ekzistuese;
- E përshtatshme për t'u hequr pa pasoja për sitin.

6. Monumentet që do të trajtohen me ndriçim

Lista e monumenteve përbën një orientim paraprak. Përfshirja përfundimtare dhe niveli i ndriçimit do të përcaktohen pas analizës teknike, mjedisore dhe konservuese gjatë fazës së projektimit.

6.1 Teatri antik

Ndriçimi do të:

- Theksojë formën, volumin dhe konfigurimin arkitektonik të teatrit;

Butrint Management Foundation

info@bmf.al

Parku Kombëtar Butrint, SH81, Sarandë, Shqipëri

- Lejojë përdorimin e kontrolluar për aktivitete kulturore;
- Shmangë ndriçimin e fortë dhe ndërhyrjet në strukturë.

6.2 Pagëzimorja

Ndriçimi do të:

- Realizohet në mënyrë indirekte;
- Theksojë volumin dhe hapësirën e brendshme;
- Shmangë ndriçimin e drejtpërdrejtë mbi dyshtemenë e mbuluar me mozaikë dhe kolonat e tij;
- Përdorë dritë të butë dhe të kontrolluar;
- Ruajë atmosferën autentike të monumentit.

6.3 Bazilika e Madhe

Ndriçimi do të:

- Jetë i butë dhe i shpërndarë,
- Respektojë errësirën natyrore të zonës pyjore përreth dhe pranë monumentit,
- Shmangë çdo efekt dominues ose dekorativ.

6.4 Porta e Liqenit

Ndriçimi do të:

- Trajtohet në mënyrë shumë të kufizuar,
- Shmangë ndriçimin e drejtpërdrejtë të strukturës,
- Shërbejë për orientim dhe lexim hapësinor,
- Theksojë karakterin monumental të portës,
- Shmangë ndikimin në ekosistemin ujor dhe faunën përreth liqenit.

6.5 Porta e Luanit

Ndriçimi do të:

- Jetë minimal dhe jo dominues;
- Theksojë leximin e strukturës pa e ekspozuar atë në mënyrë dekorative;
- Ruajë karakterin arkeologjik të zonës.

7. Itineraret e Vizitorëve

Instalimi i rrjetit elektrik dhe ndriçimi i itinerareve të vizitorëve përbën një komponent thelbësor të këtij projekti, pasi lidhet drejtpërdrejt me sigurinë, orientimin, menaxhimin e flukseve të vizitorëve dhe çdo aktivitet tjetër në shërbim të tyre, brenda sitit arkeologjik. Itineraret përfaqësojnë hapësirat ku ndriçimi funksional është i domosdoshëm dhe i justifikuar, duke lejuar lëvizje të kontrolluar pa cënuar integritetin e monumenteve, peizazhin natyror dhe ekosistemet e ndjeshme.

Ndriçimi i itinerareve do të konceptohet si ndërhyrje minimale dhe e kthyeshme, e integruar në terren, pa gërmime destruktive dhe pa ndikim në shtresat arkeologjike apo stabilitetin e terrenit. Zgjidhjet ndriçuese do të jenë diskrete, me intensitet të ulët dhe të drejtuara vetëm në sipërfaqen e lëvizjes, drejt tokës dhe jo monumentit. Ndriçimi do të jetë kontrollues për lëvizjen pa barriera fizike.

Ndriçimi i itinerareve do të projektohet në mënyrë që të shmangë ndriçimin e panevojshëm të zonave natyrore përreth, duke respektuar ciklet biologjike të faunës së natës dhe duke reduktuar ndotjen nga drita, në përputhje me parimet e Dark Sky Lighting.



8. Elementët e Planit të Sigurisë

Ndriçimi i sigurisë do të jetë në përputhje me zonat e identifikuara me risk të lartë për akses të pa kontrolluar si dhe sinjalistikën e evakuimit.



9. Fusha e Shërbimit dhe Përshkrimi i Punëve

Shërbimi i projektimit do të përfshijë të gjitha fazat e nevojshme për hartimin e projektit të ndriçimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, aktivitetet e mëposhtme:

9.1 Studimi paraprak dhe analiza e gjendjes ekzistuese;

Kontraktori do të kryejë inspektime të detajuara në terren për të analizuar:

- Gjendjen aktuale të infrastrukturës elektrike dhe ndriçuese;
- Konfigurimin e itinerareve të vizitorëve dhe zonave monumentale;
- Kufizimet fizike, mjedisore dhe arkeologjike të zonës së ndërhyrjes.

Studimi do të shoqërohet me dokumentim fotografik, skica orientuese dhe raport narrativ.

9.2 Projektimi konceptual i ndriçimit

Në këtë fazë do të zhvillohet koncepti i përgjithshëm i ndriçimit, i cili do të trajtojë ndriçimin si një sistem të integruar dhe koherent, duke përfshirë:

a) Ndriçimin monumental, i cili synon theksimin dhe valorizimin e monumenteve dhe strukturave arkeologjike, duke respektuar parimet e konservimit dhe duke përdorur ndriçim diskret, jo invaziv dhe të kthyesëm (reversibël).

b) Ndriçimin e itinerareve të lëvizjes së vizitorëve, i cili synon garantimin e sigurisë dhe orientimit gjatë lëvizjes në shtigje, zona hyrje-daljeje dhe pika ndalimi.

Koncepti duhet të minimizojë ndotjen e dritës, të mbrojtë faunën dhe të integrohet natyrshëm në peizazhin historik dhe natyror të parkut.

c) Shtimin e burimeve të energjisë dhe pikat e lidhjes në funksion të aktivitetëve të ndryshme në Park.

9.3 Projektimi i detajuar teknik

Projekti i detajuar do të përfshijë:

- Planimetri të ndriçimit dhe rrjetit elektrik;
- Vizatimet e projekt-zbatimit të rrjetit elektrik;
- Skema elektrike, llogaritje të ngarkesave dhe dimensionimeve;
- Përzgjedhje të pajisjeve ndriçuese të përshtatshme për zona arkeologjike, në prezencë uji/lagështie dhe kripe;
- Detaje teknike për instalim pa ndërhyrje destruktive në terren;
- Prerje gjatësore tërthore për linjën e ndriçimit;
- Specifikime teknike dhe preventiv për zbatim;
- Relacion teknik për projektin e zbatimit;
- Sistemi i tokëzimit: Të gjithë aksesoret dhe pajisjet inkorporuar në strukturë duhet të jenë të lidhura elektrikisht me sistemin e tokëzimit. Sistemi i jashtëm dhe i brendshëm i tokëzimit duhet të jetë sipas skemave përkatëse në përputhje me standardet IEC dhe rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik;
- Grafikun e punimeve të zbatimit;
- Raport i vlerësimit të ndikimit arkeologjik;
- Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Trashëgimi (HIA)
- Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
- Prezantim i projektit në powerpoint.
- Rendera dhe videomontazhe.
- Planin e mirëmbajtjes.

10. Staf i Kyç dhe Kërkesat për Licenca Profesionale

Operatori ekonomik duhet të disponojë një ekip multidisciplinar, ku përfshirja e stafit të mëposhtëm është e detyrueshme:

a) Arkitekt Projektues me eksperiencë në ndriçim peizazhi dhe monumental

Operatori duhet të angazhojë një arkitekt me përvojë specifike në projektimin e ndriçimit monumental, i cili duhet:

- të jetë i licencuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, Vendimi nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim", kategoria 2, Projektues Arkitekt, pika b-1 dhe d;
- të ketë përvojë të dokumentuar në projekte ndriçimi monumental, arkitektonik ose të trashëgimisë kulturore;
- të udhëheqë konceptin estetik dhe interpretues të ndriçimit;
- të sigurojë integrimin harmonik të ndriçimit me arkitekturën dhe peizazhin historik;
- të bashkëpunojë ngushtë me inxhinierin elektrik dhe arkeologun gjatë gjithë procesit të projektimit.

b) Inxhinier Elektrik

Inxhinieri elektrik duhet:

- të jetë i pajisur me licencë profesionale të vlefshme "Projektues Instalator", kategoritë 4c "Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale" dhe 4/i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha etj.;

Butrint Management Foundation

info@bmf.al

Parku Kombëtar Butrint, SH81, Sarandë, Shqipëri

- të ketë përvojë në projekte ndriçimi publik ose ndriçimi të jashtëm;
- të jetë përgjegjës për zgjidhjet teknike, llogaritjet elektrike dhe përputhshmërinë me standardet EN/IEC.

c) Arkeolog

Për shkak të karakterit arkeologjik të zonës, përfshirja e një arkeologu është e detyrueshme. Arkeologu duhet:

- të jetë i licencuar sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore, kategoria A1 “Vëzhgim arkeologjik”;
- të marrë pjesë në fazën e studimit dhe projektimit;
- të identifikojë zonat me ndjeshmëri arkeologjike;
- të japë rekomandime për vendosjen e pajisjeve ndriçuese dhe traseve elektrike;
- të sigurojë që projekti të mos çenojë vlerat arkeologjike të sitit.

d) Projektues Restaurator

I specializuar dhe licencuar në fushën e studimit e projektimit në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore, ku të përfshihet kategoria:

- P/A/1. Projektim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike.

11. Metodologjia

Konsulenti duhet të mbledhë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues për zonën dhe objektin ku do të ndërhyhet. Kjo përfshin gjendjen aktuale të instalimeve elektrike, ndriçimit ekzistues, dhe zonat e veçanta me interes arkeologjik ose historik.

Projektimi elektrik dhe i ndriçimit duhet të respektojë të gjitha normat dhe elementët e sigurisë sipas standardeve aktuale në Shqipëri (KTP – STASH). Për elemente të veçanta që nuk mbulohen nga këto standarde, konsulenti duhet të referohet tek Eurostandarde (EN, ED), Euronorms (EN) dhe rekomandime ndërkombëtare nga CEI, CENELEC, DIN, VDI/VDE.

Të gjitha instalimet elektrike dhe ndriçimi duhet të planifikohen në mënyrë që të mos dëmtojnë strukturën historike ose vizualitetin. Konsulenti mund të propozojë sisteme speciale të ndriçimit dhe kabllave për të minimizuar ndikimin fizik dhe vizual.

Konsulenti duhet të analizojë dhe çertifikojë gjendjen e të gjitha elementeve elektrike ekzistuese: siguria, funksionaliteti, materialet dhe pajisjet. Bazuar në këtë analizë, do të propozohet dizajni i ri i ndriçimit dhe instalimeve.

Konsulenti përgatit preventivin e zbatimit sipas manualeve të çmimeve të aplikueshme dhe standardeve të projektimit elektrik.

Për çdo komponent të ndriçimit dhe instalimeve, specifikimet përfshijnë: përshkrimin e detajuar të punimeve, mënyrën e vendosjes, cilësinë dhe formatet e lejuara, ngjyrën e rekomanduar, dhe skica ose vizatime ilustrative.

Projektuesi duhet të përdorë programet kompjuterike të kërkuara për projektimin elektrik dhe ndriçimin, duke nxitur përdorimin e softuerëve më të avancuar të fushës për simulime dhe planifikim.

Gjatë gjithë procesit të projektimit, grupi duhet të analizojë dhe raportojë ecurinë, duke bashkëpunuar me klientin dhe duke siguruar që projektimi të jetë në përputhje me konceptin origjinal dhe standardet ndërkombëtare të ndriçimit dhe sigurisë elektrike.

12. Produktet dhe Dokumentacioni i Dorëzueshëm;

Në përfundim të shërbimit, kontraktori duhet të dorëzojë:

- Raportin e studimit për gjendjen ekzistuese;
- Projektin konceptual të ndriçimit dhe shtrimin e rrjetit elektrik;
- Projektin e detajuar teknik të zbatimit, i cili të përfshijë pamje, prerje tërthore gjatësore, planimetri, planvendosje, skema elektrike dhe detaje teknike të elementeve të ndriçimit;
- Planet, skemat dhe specifikimet teknike,
- Grafikon e punimeve të zbatimit;
- Preventivin;
- Relacion Teknik
- Rekomandime mjedisore (VNM), arkeologjike dhe HIA;
- Deklaratat e përgjegjësisë profesionale të konsulentit/stafit pjesmarrës në realizimin e studim-projektimit;
- Prezantimi (PPT) i Projektit të Detajuar të Zbatimit;
- Rendera, fotomontazhe dhe videomontazhe të propozimit;

Të gjitha fazat e projektit konsiderohen të përfunduara pas miratimit paraprak të Fondacionit dhe KKTKM.

I gjithë dokumentacioni i dorëzuar do të jetë në material të printuar dhe digjital si më poshtë:

- 3 kopje të raporteve të printuar në formatin A4;
- materiali grafik i printuar në format A3 dhe/ose A2 për planin e përgjithshëm
- një kopje elektronike në soft copy me raportin/materialin grafik/prezantimin në PPT dhe çdo dokument tjetër në format CAD, Excel, Word, PDF, etj.

Të gjitha projektet duhet të jenë të firmosura elektronikisht nga hartuesit e licensuar në fushat përkatëse.

ÇDO PROJEKT I PROPOZUAR DUHET TË DORËZOHET PRANË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE PËR MIRATIM.

Sipas Ligjit Nr. 27/2018 për "Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", është e rëndësishme të respektohet VKM Nr. 1099 datë 24.12.2020 për "Normat Teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjes në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore" dhe VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 "Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre".